Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikime
Nacionalni Autoritet za Kvalifikac
National Qualification Authority

Numër: 01-540 Datë: 29.07.2025

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2025 merr:

V E N D I M

I. **Riakreditohet dhe Rivalidohet,** *" Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve te Kosovës (SHKCAK)"*, me adresë: Ukshin Hoti, nr. 130, Prishtinë, Kosovë, 10000. Republika e Kosovës, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **TEKNIK I KONTABILITETIT,** kualifikim i bazuar në Standardet Ndërkombëtare (E). Niveli V-të sipas KKK-së, 52 kredi të AAP-së, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 31.03.2024 deri 30.03.2029. Institucioni ka mundësi të regjistrojë deri në 50 kandidatë për çdo sesion trajnimi (2 sesione), në total 100 kandidatë gjatë një viti.

2. **KONTABILIST I CERTIFIKUAR,** kualifikim i bazuar në Standardet Ndërkombëtar (E) Niveli V-të sipas KKK-së, 52 kredi të AAP-së, për periudhën pesë (5) vjeçare përkatësisht nga data 31.03.2024 deri 31.03.2029. Institucioni ka mundësi të regjistrojë deri në 50 kandidatë për çdo sesion trajnimi (2 sesione), në total 100 kandidatë gjatë një viti.

3. **Auditor i Brendshëm i Certifikuar i Sektorit Publik dhe Privat** kualifikimi i bazuar në Standardet Ndërkombëtare (E). Niveli V sipas KKK me 85 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare përkatësisht nga data 31.03.2024 deri 31.03.2029. Institucioni ka mundësi të regjistrojë deri në 50 kandidatë për çdo sesion trajnimi (2 sesione), në total 100 kandidatë gjatë një viti.

4. **Auditor i Certifikuar**, kualifikimi i bazuar në Standard Ndërkombëtar (E). Niveli V sipas KKK me 92 kredi të AAP-së, për periudhën pesë (5) vjeçare përkatësisht nga data: 31.03.2024 deri më: 31.03.2029. Institucioni ka mundësi të regjistrojë deri në 50 kandidatë për çdo sesion trajnimi (2 sesione), në total 100 kandidatë gjatë një viti.

5. **Auditor i Certifikuar i Sektorit Publik**, kualifikim i bazuar në Standardet Ndërkombëtar (E). Niveli V sipas KKK me 98 kredi të AAP, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data: 31.03.2024 deri më: 31.03.2029. Institucioni ka mundësi të regjistrojë deri në 50 kandidatë për çdo sesion trajnimi (2 sesione), në total 100 kandidatë gjatë një viti.

II. Obligohet Institucioni të plotësojë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "SHKCAK", ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimet e cekura në pikën nr. 1 të këtij vendimi.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë: 01.02.2024 kanë realizuar vizitën në institucionin "SHKCAK", sipas afateve ligjore kanë përpiluar raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim për kualifikimet për të cilat institucioni ka parashtruar kërkesë bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës.

Raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 25.07.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve, aplikacionet për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitës së realizuar tek pala aplikuese.

Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të zbatimit të drejtë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë ka nxjerr vendimin Nr.01/402 të datës 13.06.2024, sipas të cilit janë të përcaktuara kriteret që Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional duhet ti përmbushin në afat kohor 3 deri 6 muaj.

Ndërsa AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit "SHKCAK", për riakreditim dhe rivalidim, rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Shoqata e Kontabilisteve të Certifikuar dhe Auditorëve te Kosovës (SHKCAK), dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve